



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

Tiranë më 5.2.2019

RAPORT

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË MINISTRIT TË FINANCave PËR EMËRIMIN
E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE QË
DO TË MBAJË FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV TË AUTORITETIT**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 4.2.2019, mori në shqyrtim propozimin e Ministrit të Financave për emërimin e Znj. Mimoza Kaçi në pozicionin e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv të këtij institucioni. Shyrtimi i këtij propozimi në Komision u bë bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenet 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar”, të ndryshuar.

Për shqyrtimin e këtij propozimi u caktua relator Znj. Evis KUSHI.

Në mbledhjen e komisionit ishte e pranishme Znj. Kaçi e cila bëri një prezantim përmbledhës mbi edukimin akademik dhe eksperiencën profesionale si dhe mbi vizionin dhe platformën e saj lidhur me pozicionin për të cilin ri-propozohet.

II. Analiza formale-ligjore

Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar”, të ndryshuar, anëtari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv të Autoritetit, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Ministrit të Financave, pas një procedure përzgjedhëse.

Në respektim të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ministria e Financave, kreu procedurën përzgjedhëse, konform parashikimeve ligjore të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, duke shqyrtuar për këtë qëllim kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Në përfundim të procesit përzgjedhës, Ministri i Financave, përmes shkresës nr. 22900/6 datë 11.01.2019, ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë, propozimin për ri-emërimin në këtë detyrë të Znj. Mimoza Kaçi, e cila u vlerësua si më e përshtatshme.

Zj. Kaçi u zgjodh anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që mban edhe funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv përmes vendimit të Kuvendit nr. 109 datë 24.12.2014. Ky mandat ka përfunduar, më 24 dhjetor 2018, por zonja Kaçi për shkak të parashikimit ligjor (neni 7 të ligjit) është aktualisht në detyrë, deri në momentin e zgjedhjes së anëtarit të ri.

Referuar nenit 11 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit ia ka kaluar menjëherë propozimin e ardhur nga Ministri i Financave, Komisionit përgjegjës parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Në respektim të pikës 5, 7 e 8 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, brenda afateve, shqyrto1 përmëshjen e kriterëve ligjorë dhe meritën e kandidaturës si dhe organizoi seancë dëgjimore publike me kandidatin. Kuvendi shqyrton kërkesën në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës. Kur asnjë nga kandidatët, nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Kuvendit.

Kushtet ligjore të parashikuara nga neni 5 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar”, të ndryshuar, përmëshja e të cilave është verifikuar nga Ministria e Financave gjatë procedurës përzgjedhëse janë:

1. *Të jenë shtetas shqiptarë.*
2. *Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve*
3. *Me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:*
 - a) *financë-kontabilitet;*
 - b) *administrim i shoqërive tregtare;*
 - c) *këshillim ligjor i shoqërive tregtare;*
 - ç) *hartim legjislacioni;*
 - d) *shkencë e aktuarëve;*
 - dh) *sigurime shoqërore dhe pensione.*
4. *Me integritet moral dhe profesional.*
5. *Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.*
6. *Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykatë të formës së prerë.*
7. *Në përmëshje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.*

Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit persona, të cilët:

- a. në tre vitet e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;*
- b. kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi;*
- c. në tre vitet e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtori ekzekutiv i Autoritetit nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjetër me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore shkencore, apo pjesëmarrjes në organizata vendase apo ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit.

Çdo anëtar i Bordit ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara në këtë nen.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Ministria e Financave që shoqëronte propozimin, konstatoi se procedura përzgjedhëse ishte bërë konform parashikimeve të nenit 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiar”, të ndryshuar.

Gjithashtu gjatë analizimit të dokumentacionit lidhur me procedurën përzgjedhëse nga Ministria e Financave por edhe duke patur prezent faktin se Znj. Kaçi për shkak të parashikimeve ligjore, është në këtë detyrë dhe emërimi i saj nga Kuvendi ka kaluar përmes të njëjtës procedurë parlamentare, vlerësoi se ajo i plotëson kriteret për t’u emëruar anëtar i Bordit si dhe plotëson kushtëzimet ligjore lidhur me papajtueshmërinë. Kështu:

- Znj. Kaçi plotëson kriterin lidhur me arsimimin (neni 5 pika 2). Ajo ka kryer studimet universitare dhe Master në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit Vjenë, me profilizim në fushën e financës: Bankingu Investues dhe Industria e Sigurimeve dhe mban titullin doktor shkencash në financë;
- Plotësohet kriteri lidhur me përvojën profesionale (neni 5, pika 3), dhe çmohet kontributi i saj dhënë në vijimësi në fushën akademike;
- Plotësohen kriteret mbi integritetin moral dhe profesional, nuk ka dënime penale me vendim gjykatë të formës së prerë dhe përmbush kërkesat dhe dispozitat ligjore për konfliktin e interesave duke plotësuar kështu edhe kushtëzimet e nenit 5, pikat 4,6 dhe 7;
- Znj. Kaçi nuk është e anagazhuar në funksione drejtuese partiiale (neni 5 pika 5). Gjithashtu nuk ka pengesa dhe papajtueshmëri me funksionin për të ri-kandiduar në këtë post;

Gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të bordit dhe nëndrejtorit ekzekutiv të AMF-së, Znj. Kaçi është angazhuar për rritjen e frymës së bashkëpunimit me të gjithë anëtarët e bordit, me qëllim evidentimin dhe dhënien e zgjidhjeve lidhur me problematika specifike në vijimësi. Ajo është angazhuar dhe ka dhënë një kontribut të vlefshëm në drejtim të përmbushjes së objektivave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare lidhur me mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe të

personave të siguruar, nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyren, respektimin e ligjit etj.

Komisioni çmon përvojën profesionale dhe kontributin e Znj. Kaçi dhe vlerëson se është një kandidaturë serioze, që plotëson kriteret ligjore për tu emëruar anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv të Autoritetit.

III. Përfundime

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me nenin 34 të Rregullores së Kuvendit, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, mbështetur në nenin 111, të Rregullores së Kuvendit, miratoi propozimin e Ministrit të Financave për emërimin e Znj. Mimoza Kaçi, si anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv të Autoritetit dhe i propozon Kuvendit të Shqipërisë emërimin e saj në këtë pozicion.

Bashkëlidhur projekt-vendimi për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit, të Mbikqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të Autoritetit.

RELATOR

EVIS KUSHI

KRYETAR

ARBEN AHMETAJ